



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1584/12 prot.

Datë 04.07.2024

V E N D I M

Nr. 804/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.07.2024 , mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 755/2024, datë 26.06.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur” me Nr. REF-01577-04-16-2024, me objekt “Lot 2 ‘Mirëmbajtja full risk’”, e pajisjes mjekësore të prodhuesit Siemens”, me fond limit 10,080,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MSE” SHPK NIPT L82001005A, Adresa: Rruga “Diga e Liqenit”, Nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër. Adresa: Rruga “Kolë Heqimi”, Shkodër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 755/2024, ku vendosi: [...] 1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-01577-04-16-2024, me objekt “Lot 2 ‘Mirëmbajtja full risk’, e pajisjes mjekësore të prodhuesit Siemens”, me fond limit 10,080,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të vendimit zyrtar të caktuar për shqyrtimin e ankesës.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “MSE” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1677/3 prot., datë 01.07.2024, protokolluar me tonën nr. 1584/9 prot., datë 03.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.755/2024 datë 26.06.2024 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-01577-04-16-2024, me objekt “Lot 2 ‘Mirëmbajtja full risk’, e pajisjes mjekësore të prodhuesit Siemens”, me fond limit 10,080,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1677/3 prot., datë 01.07.2024, protokolluar me tonën nr. 1584/9 prot., datë 03.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.755/2024 datë 26.06.2024 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-01577-04-16-2024, me objekt “Lot 2 ‘Mirëmbajtja full risk’, e pajisjes mjekësore të prodhuesit Siemens”, me fond limit 10,080,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe nga shqyrtimi në SPE, Komisioni Prokurimit Publik vëren se autoriteti

kontraktor ka kryer rivlersimin në zbatim të vendimit të KPP 755/2024 datë 26.06.2024 duke kualifikuar operatorin ekonomik “MSE” SHPK.

KPP konstaton se autoriteti kontraktor , Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 755/2024 datë 26.06.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-01577-04-16-2024, me objekt “Lot 2 ‘Mirëmbajtja full risk’, e pajisjes mjekësore të prodhuesit Siemens”, me fond limit 10,080,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Shkodër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri